



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.77/16, gusht 2010), si dhe pjesës IV dhe nenit 85 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.11/11, maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në takimin e mbajtur më 29 gusht 2019, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR QEVERISJEN KORPORATIVE TË BANKAVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të harmonizoj kornizën rregullative lidhur me praktikën e mirë të qeverisjes korporative të bankave, si faktor i rëndësishëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sektorit bankar në tërësi. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për aksionarët e bankave, Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë lidhur me përgjegjësitë e tyre në qeverisjen korporative.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat që veprojnë në Republikën e Kosovës, të licencuara nga BQK-ja.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore janë ashtu siç janë përkufizuar në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare (në vijim: Ligji për Bankat) dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllime të kësaj rregulloreje:
  - 1.1. **Qeverisja korporative** – nënkupton mënyrën e menaxhimit të afarizmit dhe aktivitetet e bankës përmes ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësisë nga aksionarët e tyre, bordet e drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë, që ndikon në mënyrën se si ata e caktojnë strategjinë dhe objektivat korporative, përzgjedhin dhe mbikëqyrin personelin, kryejnë aktivitetet e bankës në baza ditore, harmonizojnë veprimtaritë dhe sjelljet korporative me pritjen që

bankat do të operojnë në mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë dhe në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme, si dhe mënyrën e vendosjes së funksioneve kontrolluese dhe mbrojtjen e interesave të depozitorëve.

- 1.2. **Rreziku i pajtueshmërisë** – është rreziku i sanksioneve ligjore ose rregullative, i humbjeve materiale financiare apo humbjes së reputacionit si rezultat i mospajtueshmërisë së operacioneve të bankës me ligjet, rregulloret, rregullat, standardet dhe rregullat e brendshme të organizimit, si dhe me kodet e mirësjelljes të aplikueshme për veprimtaritë e saj bankare (të referuar bashkërisht si: *ligjet dhe rregulloret në fuqi*).

### **Neni 3**

#### **Konfliktet me ligjet dhe rregulloret e juridiksionit të vendit amë**

Degët e bankave të huaja duhet të njoftojnë BQK-në nëse hasin në konflikte në mes të zbatimit të kësaj rregulloreje dhe ligjeve dhe rregulloreve të cilat i zbatojnë në juridiksionin e vendit amë. Përveç nëse lirohen në mënyrë eksplicite nga BQK-ja me anë të ndonjë rregullore apo akt tjetër juridik, ato detyrohen të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore për operacionet e tyre në Kosovë.

### **Neni 4**

#### **Vlerat korporative dhe kodi i mirësjelljes**

1. Të gjitha bankat që operojnë në Kosovë duhet të kenë të shkruar Deklaratën e Vlerave Korporative dhe Kodin e Mirësjelljes, dokumente këto të zbatueshme për të gjitha palët që punojnë për bankën, duke përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Kultura korporative e paraparë në këto dokumente e cila duhet të respektohet dhe aplikohet nga të gjitha palët, duhet të jetë e tillë që të mbështet objektivat e bankës dhe të ofrojë norma dhe nxitje të përshtatshme për sjellje profesionale dhe etike.
2. Deklarata e Vlerave Korporative dhe Kodi i Mirësjelljes së bankave duhet që të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat dhe detyrimet e kësaj rregulloreje.
3. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve duhet të shërbejnë si shembull në rolin e tyre udhëheqës, që ata i konsiderojnë si të rëndësishme dhe thelbësore, Deklaratën e Vlerave Korporative dhe Kodin e Mirësjelljes së bankës.
4. Kodi i Mirësjelljes i bankës duhet së paku të përfshijë rregulla lidhur me çështjet në vijim:
  - 4.1. Pajtueshmërinë me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Kosovë;
  - 4.2. Trajtimin e konfliktit të interesit;
  - 4.3. Interesat e jashtme afariste, duke përfshirë veprimtaritë investuese dhe punësimet e jashtëm të anëtarëve të Bordit, menaxhmentit dhe personelit;
  - 4.4. Trajtimin e informatave konfidenciale;

- 4.5. Pranimin e përfitimeve, dhuratave dhe favoreve të tjera;
5. Deklarata e Vlerave Korporative dhe Kodi i Mirësjelljes të bankës duhet të vihen në dispozicion të konsumatorëve të bankës sipas kërkesës. Bankat inkurajohen t'i vënë këto deklarata në dispozicion të publikut në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i publikojnë ato në uebfaqen e tyre.

## **Neni 5**

### **Trajtimi i çështjeve shqetësuese**

Çdo bankë duhet të krijoj një proces të qartë me shkrim, përmes të cilit punonjësit mund t'i komunikojnë menaxhmentit të lartë apo anëtarit të Bordit të Drejtorëve, çfarëdo shqetësimi legjitim që kanë në lidhje me praktikat dhe veprimtaritë e paligjshme, jo-etike dhe të dyshimta në rastet kur çështja përfshinë një anëtar të menaxhmentit të lartë të bankës. Procesi duhet të jetë i atillë që t'i krijoj punonjësit besimin që mund të komunikojë çështje të tilla në mbrojtje të plotë nga çfarëdo forme të ndëshkimit.

## **Neni 6**

### **Pronësia e bankës**

1. Qeverisja e mirë korporative kërkon që aksionarët e të gjitha bankave që veprojnë në Kosovë të jenë të duhur dhe të përshtatshëm. BQK-ja në bazë të kornizës ligjore ka kompetencë të vlerësoj dhe të sigurohet se të gjithë pronarët kryesorë të një banke të propozuar përmbushin këtë kërkesë.
2. Aksionarët e bankës duhet të kenë një vizion strategjik të pronësisë së bankës nga ana e tyre dhe duhet t'ia komunikojnë atë bordit, pasi që pa udhëzime nga aksionarët në këtë drejtim, bordi dhe menaxhmenti i një banke do të kenë vështirësi në përcaktimin e drejtimit të qartë strategjik për bankën, si dhe në menaxhimin e saj drejt arritjes së këtyre objektivave.
3. Aksionarët e bankës duhet t'i plotësojnë këto kërkesa për pronësi, të jenë të duhur dhe të përshtatshëm, në vazhdimësi. Sipas nenit 37 të Ligjit për Bankat, të gjithë aksionarët kryesorë duhet të kenë miratimin paraprak të BQK-së në mënyrë që të sigurohet që aksionarët e rinj gjithashtu t'i plotësojnë kriteret e të qenit të duhur dhe të përshtatshëm. BQK-ja shqyrton cilësinë e pronësisë së bankës në kuadër të ekzaminimit të qeverisjes korporative të një banke, për të siguruar që të ruhet standardi i lartë i kërkuar për pronarët e bankave në Kosovë.
4. Sipas nenit 37, paragrafi 4 të Ligjit për Bankat, çdo bankë duhet ta njoftojë BQK-në për çdo përvetësim të aksioneve brenda pesë (5) ditëve pas përvetësimit të shumës së aksioneve që është e barabartë ose tejkalon pesë përqind (5%) të kapitalit por që nuk tejkalon dhjetë përqind (10%) të tij. Njoftimi bëhet në atë mënyrë që të përmban informacionet që mund të kërkohen nga BQK-ja.

## **Neni 7**

### **Pronësia përfituese**

1. Sipas nenit 7 të Ligjit për Bankat, për t'u licencuar nga BQK-ja, banka duhet të ofrojë listën e aksionarëve që mbajnë apo do të mbajnë pesë (5%) përqind a më shumë të aksioneve, si dhe të pronarëve përfitues të këtyre aksioneve, duke cekur emrat e tyre, adresën dhe posedimin përkatës të aksioneve.
2. Nëse BQK-ja ka arsye që të dyshojë në lidhje me pronësinë përfituese përfundimtare të një pjese të konsiderueshme të aksioneve të një banke që vepron në Kosovë, ajo do t'i blloktojë ato aksione nga pjesëmarrja në menaxhmentin e bankës deri në momentin kur vërtetohet pronësia përfituese përfundimtare dhe e njëjta i plotëson kriteret e të qenit të duhur dhe përshtatshëm sipas Ligjit për Bankat. Nëse BQK-ja ka shqetësime të shpeshta apo të vazhdueshme në lidhje me pronësinë përfituese përfundimtare të një banke, ajo do të ndërmarrë veprime korrigjuese të cilat mund të përfshijnë, në raste të jashtëzakonshme, revokimin e licencës së bankës në fjalë.

## **Neni 8**

### **Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve**

1. Qeverisja e mirë korporative fillon me mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve. Neni 24 i Ligjit për Bankat parasheh që mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve të mbahen të paktën një herë në vit. Mbledhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionarëve mund të mbahen sipas nevojës në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 24.4 të Ligjit për Bankat.
2. Çështjet për të cilat merret vendim në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve janë përcaktuar në nenin 24.7 të Ligjit për Bankat dhe ndër të tjera përfshijnë:
  - 2.1. Krijimin e kapitalit fillestar të paguar të bankës nëpërmjet emetimit ose rritjes së aksioneve të zakonshme dhe emetimit ose rritjes së aksioneve të preferuara;
  - 2.2. Emërimin e auditorit të jashtëm të bankës;
  - 2.3. Miratimin e raportit vjetor financiar të bankës;
  - 2.4. Shpërndarjen e fitimit dhe pagesën e dividendës ose mënyrën e mbulimit të humbjeve nëse banka ka rezultuar me humbje;
  - 2.5. Zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në baza individuale;
  - 2.6. Caktimin e kompensimeve për anëtarët e bordit të drejtorëve dhe anëtarëve të jashtëm të komiteteve të bordit;

## **Neni 9**

### **Përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve të një banke**

1. Bordi i një banke e mban përgjegjësinë kryesore për cilësinë e qeverisjes së bankës. Bordi duhet ta kryejë këtë rol me objektivin që të sigurojë se institucioni menaxhohet në një mënyrë që ruan sigurinë dhe qëndrueshmërinë e tij, dhe që operon në mënyrë të atillë që merr parasysh interesat e të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë aksionarët, depozitorët dhe palët e tjera relevante të interesit.
2. Bordi gjithashtu duhet të sigurojë që institucioni operon në pajtueshmëri me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse të Kosovës, pasi që Bordi është përgjegjësi kryesor për të gjitha veprimet ose lëshimet e bankës, duke përfshirë respektimin nga ana e saj të detyrimeve ligjore dhe rregullative.
3. Bordi duhet të ketë gjykime të shëndosha dhe objektive, të posedojnë kualifikimet dhe kompetencën e duhur, individualisht dhe si tërësi, të ndjekin praktikën e mira të qeverisjes në funksion të detyrave të tyre në bord, si dhe të mbështeten nga funksione adekuate, profesionale dhe të pavarura të menaxhimit të rrezikut, pajtueshmërisë, auditimit dhe kontrollave, të cilat bordi duhet ti mbikëqyrë në mënyrë efektive.
4. Bordi ka përgjegjësi kryesore për strategjinë afariste dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës, vendimet kyçe lidhur me personelin, organizmin e brendshëm si dhe strukturën dhe praktikën e menaxhimit, dhe detyrimet e menaxhimit të rrezikut dhe pajtueshmërisë. Bordi mund të delegojë disa prej funksioneve të tij tek komitetet e bordit kur një gjë e tillë është e përshtatshme, por jo edhe përgjegjësitë.
5. Bordi duhet të krijoj strukturën organizative të bankës. Kjo do të i mundësojë Bordit dhe menaxhmentit të lartë të përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe të lehtësojnë vendimmarrjen efektive dhe qeverisjen e mirë. Kjo përfshin përcaktimin e qartë të përgjegjësive dhe kompetencave kyçe të vetë Bordit dhe të menaxhmentit të lartë, si dhe të atyre që janë përgjegjës për funksionet e menaxhimit të rrezikut dhe funksionet e kontrollit.
6. Bordi i Drejtorëve të një banke i ka këto përgjegjësi të veçanta:
  - 6.1. Të përzgjedh Kryesuesin e Bordit nga radhët e anëtarëve jo-ekzekutivë të Bordit;
  - 6.2. Të miratoj dhe mbikëqyrë realizimin e objektivave strategjike të institucionit dhe shqyrtoj këto objektiva strategjike kohë pas kohe për të siguruar që ato mbeten konsistente me mjedisin operativ të institucionit;
  - 6.3. Të mbikëqyr zbatimin e kornizës qeverisëse të bankës dhe të rishikoj në mënyrë periodike që ajo mbetet e përshtatshme karshi ndryshimeve materiale të madhësisë së bankës, ndërlikueshmërisë, shtrirjes gjeografike, strategjisë afariste, tregjeve dhe kërkesave rregullative.
  - 6.4. Të miratoj dhe mbikëqyrë strategjinë e institucionit për menaxhimin e rrezikut, përfshirë kufijtë e tolerancës së rrezikut të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

- 6.5. Të përcaktoj bashkë me menaxhmentin e lartë dhe zyrtarin kryesor për rrezik (në tekstin e mëtejshëm: ZKR), gatishmërinë e bankës për rrezik (anglisht: risk appetite), duke marrë parasysh kornizën rregullative dhe interesat afatgjata të bankës, ekspozimin ndaj rrezikut dhe mundësinë për të menaxhuar rrezikun me efikasitet.
  - 6.6. Të përcaktoj vlerat korporative të institucionit dhe të sigurohet që sjellja e vetë anëtarëve të bordit dhe e të gjithë zyrtarëve të institucionit është konsistente me ato vlera;
  - 6.7. Të emëroj dhe mbikëqyr menaxherët e lartë kompetentë për të marrë përgjegjësi për menaxhimin ditor të institucionit dhe të sigurohet që ata veprojnë në mënyrë konsistente me objektivat strategjike, kufijtë e rrezikut dhe vlerat korporative të institucionit;
  - 6.8. Të përcaktoj pakon e kompensimit të menaxhmentit të lartë dhe të siguroj që stimujt e ofruar janë konsistente me objektivat dhe vlerat e institucionit;
  - 6.9. Të zhvilloj dhe dokumentoj Kodin e Mirësjelljes për të gjithë menaxhmentin dhe personelin e institucionit dhe të sigurohet që i njëjti zbatohet në praktikë;
  - 6.10. Të rishikoj, miratoj dhe monitoroj planet dhe buxhetet vjetore afariste të institucionit;
  - 6.11. Të miratoj marrëveshjet kontraktuese dhe të siguroj që marrëveshjet me shkrim të nivelit të shërbimit i përcaktojnë përgjegjësitë e palëve përkatëse para se të fillojnë marrëveshjet dhe që ato janë në interesin më të mirë të bankës. Kjo kërkesë zbatohet për marrëveshjet kontraktuese me palët e ndërlidhura me bankën, duke përfshirë bankat amë;
  - 6.12. Të përcaktoj informatat që duhet të merren nga menaxhmenti në mënyrë që të mund t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe t'i analizojnë ato raporte me kujdes dhe hollësisht kur pranohen;
  - 6.13. Të përcaktoj informatat që duhet marrë nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit dhe diskutimi dhe përcjellja e atyre raporteve kur ato merren;
  - 6.14. Të siguroj transparencë dhe bashkëpunim profesional me BQK-në;
  - 6.15. Të thirr mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve.
7. Në kuadër të kornizës së përgjithshme të qeverisjes korporative, Bordi është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e kornizës së qeverisjes së rrezikut. Korniza efektive e qeverisjes së rrezikut përfshin kulturën e fuqishme të rrezikut, gatishmërinë për rrezik të përcaktuar mirë përmes politikave të rrezikut apo deklaratave me shkrim për gatishmërinë për rrezik, si dhe përgjegjësitë e përkufizuara mirë për menaxhimin e rrezikut në veçanti dhe për funksionet e kontrollave në përgjithësi.
  8. Bordi duhet të marrë rol aktiv në përcaktimin e gatishmërisë për rrezik dhe në sigurimin e harmonizimit të tij me planet strategjike, kapitale dhe financiare të bankës, si dhe me praktikën e kompensimit. Gatishmëria e bankës për rrezik duhet të transmetohet në mënyrë të qartë, përmes politikës së rrezikut ose deklaratës së gatishmërisë për rrezik, që mund të kuptohen

lehtësisht nga të gjitha palët përkatëse si: Bordi i drejtorëve, menaxhmenti i lartë, punonjësit e bankës dhe BQK-ja.

9. Politika e bankës për gatishmërinë për rrezik ose deklarata e gatishmërisë për rrezik duhet që:
  - 9.1. Të përfshijë elementet sasiore dhe cilësore;
  - 9.2. Të përcaktojë nivelin individual dhe të kombinuar dhe llojet e rreziqeve që banka është e gatshme të marrë përsipër paraprakisht dhe me qëllim të realizimit të veprimtarive të saja afariste në kuadër të kapacitetit të saj të marrjes së rreziqeve;
  - 9.3. Të përcaktoj kufijtë dhe aktivitetet afariste në përputhje me të cilat banka pritet të operojë në kuadër të realizimit të strategjisë afariste;
10. Komunikimi me efikasitet i gatishmërisë për rrezik të përcaktuar nga Bordi, në të gjithë bankën, duke lidhur atë me vendimmarrjen operative ditore dhe vendosjen e mjeteve dhe metodave efektive për të ngritur çështjet e rrezikut dhe shqetësimet strategjike në të gjithë bankën.
11. Përgjegjësitë individuale të Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve janë:
  - 11.1. Të sigurojnë që vepronë në interesin më të mirë të bankës në tërësi dhe jo vetëm në interesin më të mirë të aksionarit kryesor që i ka caktuar ata;
  - 11.2. Të jenë të vetëdijshëm për mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të bankës, duke përfshirë zhvillimet ekonomike dhe financiare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe ndryshimet statutoare dhe rregullative që e prekin bankën;
  - 11.3. Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit, të përgatiten para mbledhjes duke shqyrtuar materialin përkatës të nevojshëm, të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutimet e Bordit dhe të kërkojnë shpjegime për materialet e panjohura apo të paqarta;
  - 11.4. Të marrin pjesë në shqyrtimet e performancës së Bordit në tërësi dhe të performancës së vetë atyre;
  - 11.5. Të bashkëpunojnë me BQK-në, si dhe të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e thirrura nga BQK-ja;
  - 11.6. Të zbulojnë të gjitha informatat e nevojshme të parapara me legjislacionin në fuqi nga koha kur aplikojnë dhe gjatë gjithë periudhës sa shërbejnë si anëtarë të Bordit;
  - 11.7. Të ushtrojnë gjykimin e pavarur dhe të mos i lejojnë vetes të ndikohen padrejtësisht nga një drejtor tjetër, nga menaxhmenti apo nga interesat e jashtme;
  - 11.8. Të shmangin konfliktet e interesit. Kjo përfshin shpалosjen e çfarëdo biznesi personal që e kanë me bankën.

12. BQK-ja ka kompetencë në kuadër të Ligjit për Bankat ta diskualifikoj një person nga Bordi i bankës nëse konsideron se nuk i plotëson këto kërkesa minimale.

## **Neni 10**

### **Emërimi dhe mbikëqyrja e menaxhmentit të lartë të bankës**

1. Bordi i bankës që vepron në Kosovë duhet ta përzgjedhë dhe emërojë menaxhmentin e lartë të institucionit dhe nëse është e nevojshme ta zëvendësojë atë. Në rastin e degëve të bankave të huaja, kjo i takon Bordit të Drejtorëve të bankës amë.
2. Me qëllim të përmbushjes së këtij roli, Bordi duhet:
  - 2.1. Të përcaktojë standarde të qenit të duhur dhe të përshtatshëm për përzgjedhjen e të gjithë menaxherëve, jo vetëm të atyre menaxherëve të lartë për të cilët nevojitet miratimi i BQK-së;
  - 2.2. Të monitorojë veprimet e menaxherëve të lartë dhe të sigurojë që ato janë në përputhje me strategjitë e miratuara dhe kufijtë e rrezikut të institucionit;
  - 2.3. Të përcaktojë standarde formale të performancës për menaxherët e lartë. Ata duhet të sigurojnë që këto standarde të performancës janë në përputhje me interesat afatgjata të institucionit dhe të mos çojnë pa-dashje në marrje të tepërt të rrezikut në aspektin afatshkurtër;
  - 2.4. Të sigurojë që njohuritë dhe ekspertiza e menaxherëve të lartë mbeten në nivelin e duhur në rast të ndryshimeve në natyrën e biznesit, profilin e tij të rrezikut ose mjedisin e tij operativ;
  - 2.5. Të ketë planin e përshtatshëm të vazhdimësisë për të siguruar që humbja e personelit të lartë apo kyç nuk ndikon negativisht në performancën e institucionit.

## **Neni 11**

### **Konfliktet e interesit**

1. Bordi duhet të ketë një politikë zyrtare të shkruar në lidhje me konfliktet e interesit apo të specifikuar në statutin e bankës, si dhe një proces objektiv dhe rigoroz për zbatimin e politikës. Politika e Bordit për konfliktin e interesit duhet që së paku të përfshijë:
  - 1.1. Detyrën e drejtorit që të shmang veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt të interesit apo paraqisnin përshtypjen e konfliktit të interesit;
  - 1.2. Procesin e shqyrtimit ose miratimit që duhet ta zbatojnë drejtorët para se të përfshihen në veprimtari të caktuara, të tilla si shërbimi në një bord tjetër, me qëllim që të sigurohet që veprimtaria nuk do të krijojë konflikt të interesit apo përshtypjen e konfliktit të interesit;
  - 1.3. Detyrën e drejtorit për të zbuluar të gjitha çështjet që mund të rezultojnë në konflikt të interesit;



- 1.4. Përgjegjësini e drejtorit për të abstenuar nga votimi në lidhje me çështjet ku anëtari mund të ketë konflikt të interesit apo ku mund të komprometohet objektiviteti i anëtarit për t'i kryer siç duhet detyrat ndaj institucionit;
  - 1.5. Mënyrën në të cilën Bordi do të trajtoj mosrespektimin e politikës së konfliktit të interesit.
2. Zbatimi i politikës së konfliktit të interesit do të monitorohet nga BQK-ja. Të gjitha rastet e mosrespektimit të kësaj politike nga ana e anëtarëve të Bordit duhet t'i raportohen BQK-së. Nëse BQK-ja konstaton se anëtari nuk i plotëson kërkesat e të qenit i duhur dhe i përshtatshëm për të qenë anëtar në Bord, do ta largojë anëtarin nga Bordi i bankës.

## **Neni 12**

### **Transaksionet me personat e ndërlidhur**

1. Bankat duhet të zbatojnë politikat e mëposhtme gjatë trajtimit të transaksioneve me personat e ndërlidhur:
  - 1.1. Të gjitha bankat duhet të kenë sisteme të besueshme të kontrollit për identifikimin, matjen, monitorimin dhe menaxhimin e transaksioneve me personat e ndërlidhur, duke përfshirë të gjitha transaksionet me aksionarët kryesor apo aksionarët me interes të konsiderueshëm;
2. Të gjitha transaksionet dhe marrëdhëniet afariste me personat e ndërlidhur duhet të bëhen në përputhje me Ligjin për Bankat dhe Rregulloren për Transaksionet ndaj Personave të Ndërlidhur me Bankën dhe Ekspozimet ndaj Punëtorëve të Bankës.

## **Neni 13**

### **Kualifikimet e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve**

1. Të gjithë anëtarët e Bordit duhet të kenë përvojë, kompetenca dhe cilësi personale adekuate. Kërkesat që BQK-ja i konsideron si të rëndësishme janë përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Bankat dhe në Rregulloren e BQK-së për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave. Rregullorja në fjalë specifikon që drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave duhet të tregojnë integritet, gjykim të shëndoshë, lidhshmëri, kompetencë dhe qëndrueshmëri financiare.
2. Bordi si grup duhet të sigurojë që spektri i plotë i njohurive dhe përvojës që nevojiten për të mbikëqyrur institucionin është brenda Bordit si tërësi. Kjo nënkupton që anëtarët e Bordit duhet të kenë edukim të fushave të ndryshme dhe përvoja të ndryshme në pajtim me këtë rregullore dhe aktet tjera relevante.
3. Asambleja e Aksionarëve duhet të vlerësojë standardin e shkathtësive dhe përvojës që ka Bordi në radhët e anëtarëve të tij karshi strukturës që do të ishte ideale për bankën e tyre. Boshllëqet e konsiderueshme të zbuluara duhet të përdoren si bazë e rëndësishme për emërimet e ardhshme të Bordit.

4. Anëtarët e Bordit duhet të miratohen nga BQK-ja në kuadër të nenit 34 të Ligjit për Bankat. BQK-ja do të marrë parasysh çështjet e përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi për të vendosur nëse do e miratojë një emërim apo jo.

#### **Neni 14**

##### **Informimi i anëtarëve të Bordit**

1. Të gjithë anëtarët e rinj të bordit, edhe nëse kanë pasur përvojë të konsiderueshme në bord në institucione të tjera, duhet të jenë të informuar në çdo kohë për specifikat e bankës që do të mbikëqyrin.
2. Të gjithë anëtarët e bordit duhet të kenë qasje dhe të jenë në hap me të gjitha çështjet relevante, përfshirë ato ligjore dhe rregullative, që ndërlidhen me sistemin bankar në Kosovë.
3. Bankat duhet të kenë udhëzimet e tyre të brendshme për anëtarët e bordit të drejtorëve dhe të ndajnë kohë, buxhet dhe burime të tjera të mjaftueshme për këtë qëllim.

#### **Neni 15**

##### **Struktura e Bordit të Drejtorëve**

1. Neni 26 i Ligjit për Bankat ka përcaktuar kërkesat minimale për strukturat e Bordit. Këto kërkesa minimale janë:
  - 1.1. Bordi përbëhet nga një numër tek prej jo më pak se pesë (5) anëtarësh;
  - 1.2. Të gjithë anëtarët e Bordit kanë të drejtë vote;
  - 1.3. Shumica e anëtarëve të Bordit duhet të jenë drejtorë të pavarur dhe jo-ekzekutivë;
  - 1.4. Së paku njëri prej anëtarëve të Bordit duhet të jetë banor i përhershëm i Kosovës;
  - 1.5. Kryeshefi Ekzekutiv shërben në Bord sipas detyrës zyrtare dhe pa të drejtë vote, për aq kohë sa ai ose ajo e mban postin e kryeshefit.
2. Për qëllim të këtij neni si dhe nenit 26 të Ligjit për Bankat, drejtorët do të konsiderohen si të pavarur nëse:
  - 2.1. Ata janë të pavarur nga menaxhmenti dhe aksionarët e bankës; dhe gjykimi i tyre do të ushtrohet vetëm për të mirën e bankës;
  - 2.2. Nuk ka konflikt faktik apo të perceptuar të interesit që rrjedh nga marrëdhëniet e tyre me bankën dhe me palët e ndërlidhura me bankën;
  - 2.3. Ata nuk janë punësuar nga banka apo palët e ndërlidhura me të, përveç si anëtar i Bordit apo këshilltar i Bordit në kompanitë tjera të grupit;

- 2.4. Ata nuk janë punësuar si drejtor ekzekutiv të kompanive tjera ku ndonjëri nga ekzekutivët e asaj kompanie shërben në Bordin e bankës;
- 2.5. Në gjashtë muajt e fundit ata nuk kanë qenë të lidhur ose të punësuar nga një auditor i jashtëm aktual i bankës;
- 2.6. BQK-ja po ashtu mund të marrë parasysh fakte dhe rrethana të tjera që ata mund t'i konsiderojnë si relevante për të vendosur nëse një drejtor është i pavarur apo jo.
3. Një drejtor i pavarur duhet t'i plotësojë këto kushte të pavarësisë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë kohës sa është anëtarë i Bordit. Nëse rrethanat e tyre ndryshojnë dhe më nuk i plotësojnë kushtet për të qenë drejtorë të pavarur, ata duhet të informojnë menjëherë BQK-në. Ata mund të mbeten në Bord, por nuk do të konsiderohen më nga BQK-ja si drejtorë të pavarur. Në këto rrethana, banka duhet të sigurojë se ata i përmbushin kërkesat ligjore lidhur me numrin minimal të drejtorëve të pavarur në Bordin e tyre.
4. Një Drejtor i pavarur mund të mbajë aksione në një bankë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 5 të Rregullores së BQK-së për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave.
5. Çdo person i propozuar si Drejtor i pavarur, përpara emërimit të tij/saj do të duhet t'i sigurojë BQK-së një deklaratë se i plotëson kushtet e kësaj rregulloreje në lidhje me pavarësinë dhe do të veprojë si Drejtor i pavarur në Bordin e bankës. Formulari i kësaj deklarate të kërkuar, që do të nënshkruhet nga anëtarët e pavarur të propozuar të Bordit, është përcaktuar nga BQK me Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
6. BQK-ja në këtë rregullore ose në ndryshimet e mëvonshme të kësaj rregulloreje, mund të vendosë kërkesa më të hollësishme se kërkesat minimale të përcaktuara me legjislacionin aktual.
7. Përbërja e Bordit duhet të jetë adekuate që të mund të përballohen rastet kur një anëtar ose disa anëtarë duhet të largohen nga vendimmarrja për shkak të konfliktit potencial të interesit.
8. Bordi, së paku në baza dy vjeçare, duhet të kryej një vet-vlerësim dhe të rishikojë përbërjen e tij, si dhe të përcaktohet për përbërjen më efektive lidhur me marrjen e vendimeve dhe përcaktimin e strategjisë.
9. Bordi duhet të mbajë të dhënat e duhura të diskutimeve dhe vendimeve. Këto, sipas kërkesës, duhet të vihen në dispozicion të BQK-së.

## **Neni 16**

### **Krijimi i Komiteteve nga Bordi i Drejtorëve**

1. Ligji për Bankat kërkon nga Bordi i çdo banke të licencuar që operonë në Kosovë, përveç degëve të bankave të huaja, të themelojë komitetin e auditimit dhe komitetin për menaxhimin e rrezikut.
2. Bordi i çdo banke mund të vendosë për themelimin e komiteteve shtesë.

3. BQK-ja, po ashtu, mund të kërkojë që të gjitha apo disa banka të kenë komitetet shtesë të Bordit.
4. Bordi duhet të precizojë në statut ose me udhëzim të shkruar përgjegjësitë, autoritetin dhe kërkesat për llogaridhënie të secilit komitet të Bordit që e themelon.
5. Statuti apo udhëzimi i komitetit duhet t'i dallojë çështjet për të cilat komiteti ka autoritet të veprorë në emër të Bordit dhe ato në të cilat komiteti mundet vetëm t'i shqyrtojë dhe t'i bëjë rekomandime Bordit.
6. Procesverbalet e të gjitha takimeve të komitetit duhet t'u dërgohen anëtarëve të Bordit pas takimit sa më shpejt që është e mundur.
7. Kur Bordi e vlerëson si të nevojshme, mund të përdorë shërbimet e konsulentëve të pavarur për të ndihmuar komitetet e caktuara.
8. Anëtarët e menaxhmentit të institucionit nuk duhet të jenë anëtarë të komitetit të Bordit. Sidoqoftë, menaxhmenti mund të ftohet në takime sipas nevojës për t'i kontribuar diskutimit.

### **Neni 17**

#### **Komiteti i auditimit**

1. Bordi i Drejtorëve duhet të themelojë Komitetin e Auditimit.
2. Komiteti i Auditimit duhet të ketë së paku tre anëtarë të përzgjedhur nga radhët e drejtorëve jo-ekzekutivë dhe ekspertëve të jashtëm.
3. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit është anëtar jo-ekzekutiv i pavarur i Bordit të Drejtorëve dhe nuk është kryesues i Bordit apo ndonjë komiteti tjetër.
4. Së paku një anëtar i Komitetit të Auditimit, i cili përzgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, duhet të jetë ekspert i jashtëm i pavarur në fushën e kontabilitetit ose auditimit me qëllim të rritjes së nivelit të ekspertizës në Komitetin e Auditimit.
5. Komiteti i Auditimit është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të institucionit, përfshirë detyrimet e tij për deklarim financiar dhe raportimin e tij financiar ndaj BQK-së.
6. Komiteti i Auditimit duhet të mbikëqyrë funksionin e auditimit të brendshëm, duke përfshirë miratimin e planeve të tyre të auditimit, si dhe të miratojë letrat e angazhimit të auditorëve të jashtëm.
7. Komiteti duhet të monitorojë përgjigjet e menaxhmentit ndaj raporteve rregullative, raporteve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe të sigurojë zgjidhje të duhur dhe në kohë të të gjitha çështjeve të ngritura.

## **Neni 18**

### **Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut**

1. Çdo bankë, përveç degëve të bankave të huaja, duhet të themelojë Komitetin për Menaxhimin e Rrezikut.
2. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut do të jetë përgjegjës për këshillimin e Bordit për identifikimin e përgjithshëm të rrezikut aktual dhe të ardhshëm të institucionit, për politikën dhe strategjinë për menaxhimin e rrezikut, dhe për mbikëqyrjen e menaxhmentit të lartë në zbatimin e strategjisë së rrezikut.
3. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut duhet të pranoj raportime dhe komunikime të rregullta nga Zyrtari Kryesor i Rrezikut (në vijim: ZKR-ja) apo ekuivalenti i tij, si dhe funksionet e tjera relevante lidhur me profilin aktual të rrezikut të bankës, gjendjen aktuale të kulturës së rrezikut, gatishmërinë e përcaktuar të rrezikut dhe limitet e përcaktuara, shkeljet e këtyre limiteve dhe planet për zvogëlimin e rrezikut (anglisht: *risk mitigation plans*).
4. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut duhet:
  - 4.1. Të përbëhet vetëm nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve të bankës;
  - 4.2. Të përfshijë anëtarë të cilët kanë përvojë në çështjet dhe praktika të menaxhimit të rrezikut;
  - 4.3. Të monitorojë të gjitha aspektet e profilit të rrezikut të bankës dhe t'i rekomandojë Bordit ndryshime të profilit nëse ndryshojnë rrethanat e bankës apo rrethanat me të cilat ballafaqohet ajo;
  - 4.4. Të mbikëqyrë strategjitë për menaxhimin e kapitalit dhe likuiditetit, si dhe të gjitha rreziqet relevante të bankës, siç janë rreziku kreditor, rreziku i tregut, rreziku operacional dhe i reputacionit, për të siguruar se ato janë në përputhje me profilin e rrezikut të deklaruar;
  - 4.5. Të mbajë mbledhje së paku çdo tre muaj, si dhe herë të tjera, sipas nevojës;
  - 4.6. Të monitorojë efektshmërinë dhe pavarësinë e funksioneve për menaxhimin e rrezikut në kuadër të bankës.

## **Neni 19**

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit të lartë**

1. Menaxhmenti i lartë është përgjegjës për operacionet e përditshme të biznesit të bankës.
2. Menaxhmenti i lartë duhet të sigurojë se veprimtaritë e institucionit kryhen në çdo kohë në mënyrë konsistente me strategjinë e biznesit të institucionit, strategjinë dhe kufizimet e rrezikut dhe politikën dhe kufizimet e tjera të specifikuara nga Bordi.

3. Anëtarët e menaxhmentit të lartë duhet të kenë përvojën, kompetencat dhe integritetin e duhur për të menaxhuar biznesin dhe personelin nën mbikëqyrjen e tyre. Ata duhet të kenë qasje në trajnime të rregullta për të mbajtur dhe avancuar njohuritë e tyre, si dhe për të qenë azhur me zhvillimet e fundit që janë përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.
4. Organizimi, procedurat si dhe vendimmarrja e menaxhmentit të lartë duhet të jenë të qarta, transparente dhe të dizajnuara për promovimin e menaxhimit efektiv të bankës. Kjo përfshin qartësinë mbi rolin, autoritetin dhe përgjegjësinë e pozitive të ndryshme brenda menaxhmentit të lartë, duke përfshirë edhe atë të ZKR-së.
5. Menaxhmenti i lartë është në veçanti përgjegjës për:
  - 5.1. Të ndihmuar Bordin në krijimin dhe ruajtjen e kulturës dhe kodit të mirësjelljes;
  - 5.2. Ligjshmërinë e operacioneve të bankës;
  - 5.3. Implementimin e strategjisë së vendosur afariste të bankës; sistemet për menaxhimin e rrezikut, kulturën e rrezikut, proceset dhe kontrollet për menaxhimin e rrezikut;
  - 5.4. Ofrimin e mbikëqyrjes së duhur për ata të cilët i menaxhon. BQK-ja nuk e konsideron mungesën e informimit nga ana e menaxhmentit të lartë si mbrojtje kur dikush në institucion shkel ligjet, rregulloret apo kodin e mirësjelljes;
  - 5.5. Vendosjen e sistemeve informative të menaxhmentit që do të sigurojnë se informatat e duhura, me kohë dhe të sakta do të vihen në dispozicion të Bordit, rregullatorëve si dhe palëve të tjera të interesit;
  - 5.6. Këshillimin e Bordit për strukturën e duhur organizative të bankës;
  - 5.7. Sigurimin se sasia dhe cilësia e personelit dhe burimet e tjera janë adekuate për kryerjen e të gjitha detyrave të institucionit;
  - 5.8. Komunikimin e drejtimit strategjik, tolerancës së rrezikut dhe linjave raportuese në tërë institucionin dhe përshkrimin dhe dokumentimin e qartë të përgjegjësive për secilin anëtar të personelit.

## **Neni 20**

### **Kualifikimet e Menaxherëve të lartë**

1. Të gjithë Menaxherët e lartë të bankave të licencuara për operim në Kosovë duhet të kenë përvojën, kompetencat dhe cilësitë personale të duhura. Kërkesat të cilat BQK-ja i konsideron se janë të rëndësishme, janë përcaktuar në nenet 31 dhe 35 të Ligjit për Bankat dhe Rregulloren e BQK-së për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave.
2. Emërimi i kryeshefit ekzekutiv dhe zëvendës kryeshefit ekzekutiv në bankat e Kosovës duhet të miratohet nga BQK-ja. BQK-ja do t'i marrë parasysh çështjet e përcaktuara në Ligjin për Bankat dhe Rregulloren për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave për të vendosur nëse miratohet apo jo emërimi.

## Neni 21

### Qeverisja korporative në degët e bankave të huaja që operojnë në Kosovë

1. Kur një bankë licençohet nga BQK-ja për operim si degë e bankës së huaj në Kosovë, zbatohen këto kërkesa:
  - 1.1. Degës nuk do t'i kërkohej të themelojë Bord në Kosovë;
  - 1.2. Emërimet e menaxhmentit të lartë të degës kërkojnë miratimin paraprak të BQK-së;
  - 1.3. Menaxhmenti i lartë pritët të garantojë se politikat dhe rregullat e grupit janë përshtatur me mjedisin në Kosovë;
  - 1.4. Menaxhmenti i lartë duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me ligjet, rregulloret, udhëzuesit e Kosovës, si dhe çfarëdo dispozite tjetër ligjore në fuqi. Çfarëdo konflikti ndërmjet kërkesave të Kosovës dhe kërkesave të vendit amë duhet të raportohet në BQK. Dega mund ta injorojë kërkesën e Kosovës vetëm nëse e pranon ndonjë përjashtim specifik nga BQK-ja për të vepruar ashtu;
  - 1.5. Dega duhet t'i ofrojë BQK-së informata të tilla në lidhje me operacionet e veta dhe të institucionit amë të saj sipas kërkesave nga BQK-ja në mënyrë që BQK-ja të jetë e kënaqur me operacionet e degës që i nënshtrohen mbikëqyrjes adekuate nga banka amë dhe mbikëqyrësit e vendit të origjinës.
2. Nëse BQK-ja vjen në përfundim se operacionet e degës vlerësohen si operacione të rëndësishme sistemike për sistemin financiar në Kosovë, për shkak të madhësisë së tyre apo ndonjë tipari tjetër, BQK-ja ka të drejtë që sipas nenit 12 të Ligjit për Bankat t'i kërkojë bankës në Kosovë të shndërrohet nga dega në një subjekt të varur.
3. Në funksion të parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut sistematik si rezultat i operacioneve të degës së bankës së huaj, do të zbatohet të paktën një nga kufizimet e mëposhtme:
  - 3.1. Vlera mesatare e aseteve të saja për dy (2) tremujorë radhazi tejkalon dhjetë (10%) përqind të totalit të aseteve të sistemit bankar;
  - 3.2. Vlera mesatare e depozitave të saja për dy (2) tremujorë radhazi tejkalon dhjetë (10%) përqind të totalit të depozitave të sistemit bankar.
4. Nëse dega e bankës së huaj arrin kufizimet sipas pikës 3 të këtij neni, BQK-ja duhet të njoftojë degën e bankës së huaj që do t'i nënshtrohet kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse të zbatueshme për subjektet e varura dhe lidhur me periudhën kohore përgjatë së cilës duhet të përmbushë të gjitha këto kërkesa rregullative të aplikuara për subjektet e varura.
5. Degëve të bankave të huaja u kërkohej t'i ofrojnë BQK-së plane të detajuara për transformimin e tyre të mundshëm në një subjekt të varur në kohën kur arrijnë nëntë (9%) përqind të aseteve apo depozitave të sistemit bankar.

## **Neni 22**

### **Kompensimi**

1. Kjo Rregullore vendos këto detyrime për bankat në lidhje me sistemet e tyre të kompensimit:
  - 1.1. Bordi duhet të sigurojë që ata e kuptojnë plotësisht mënyrën se si sistemet e kompensimit dhe stimulimit të bankës do të funksionojnë në të gjitha rrethanat dhe të jenë të kënaqur se ato janë në përputhje me interesat e bankës dhe tolerancën e tyre të rrezikut;
  - 1.2. Bordi duhet të monitorojë rregullisht funksionimin e sistemeve të kompensimit të bankës për të siguruar që ato janë duke operuar si duhet dhe nuk inkurajojnë marrjen e tepërt të rrezikut në bankë;
  - 1.3. Rezultatet e kompensimit duhet të jenë simetrike me rezultatet e rrezikut të bankës për të siguruar përputhjen e interesave të anëtarit të personelit me ato të bankës. Gjithashtu, ata duhet të kenë afate të pagesës që janë në harmoni me periudhat kohore të rreziqeve me të cilat ballafaqohet banka në mënyrë që mos të shpërblehet personeli para kohe;
  - 1.4. Paketat e kompensimit të drejtorëve, menaxhmentit të lartë dhe të personelit që mund të ndikojnë në profilin e rrezikut të bankës nuk duhet të gjitha të bazohen në parametrat e njëjta pasi kjo shton rrezikun që askush të mos e shikoj pakon nga këndvështrimi i interesave të bankës;
  - 1.5. BQK-ja rezervon të drejtën që të vlerësoj dhe nëse është e nevojshme, të kërkon ndryshime për sistemet e kompensimit në banka nëse ajo gjykon se janë të rëndësishë sisteme për sistemin financiar në Kosovë, kur beson se sistemi ekzistues i kompensimit mund të inkurajojë marrjen e tepërt të rrezikut në bankë;
  - 1.6. Përformanca e Bordit në zbatimin e këtij neni do të jetë një element i rëndësishëm i vlerësimit të performancës së përgjithshme të Bordit në kuadër të ekzaminimit të bankës nga BQK.

## **Neni 23**

### **Funksioni i menaxhimit të rrezikut**

1. Bankat duhet të kenë një funksion efektiv të pavarur të menaxhimit të rrezikut, nën drejtimin e Zyrarit Kryesor për Rrezikun (ZKR) ose një zyrtari ekuivalent, i cili duhet të ketë reputacionin, pavarësinë, burimet dhe qasjen e duhur në Bord.
2. Funksioni i menaxhimit të rrezikut është përgjegjës për mbikëqyrjen e marrjes së rrezikut në të gjithë aktivitetet e bankës dhe duhet të ketë autorizime brenda bankës për të kryer këtë detyrë. Aktivitetet kyçe të funksionit të menaxhimit të rrezikut duhet të përfshijnë:
  - 2.1. Identifikimin e rreziqeve materiale individuale, të agreguara dhe rreziqeve të reja;
  - 2.2. Vlerësimin e rreziqeve dhe matjen e ekspozimit të bankës ndaj tyre;



- 2.3. Subjekt i rishikimit dhe miratimit nga Bordi, zhvillimi dhe zbatimi i kornizës së qeverisjes të rrezikut të bankës, duke përfshirë kulturën e bankës ndaj rrezikut, tolerancën ndaj rrezikut, si dhe limitet e rrezikut;
  - 2.4. Monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarive që përbëjnë rrezik dhe ekspozimet ndaj rrezikut në përputhje me gatishmërinë e bankës për rrezik-(risk appetite) të miratuar nga Bordi, monitorimin e limiteve të rrezikut dhe nevojave përkatëse të kapitalit apo të likuiditetit;
  - 2.5. Themelimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për të monitoruar shkeljet e mundshme të tolerancës të rrezikut apo limiteve të përcaktuara të rrezikut;
  - 2.6. kur është e nevojshme të ndikojë apo të sfidojë vendimet që rrisin ekspozimin e bankës ndaj rrezikut material;
  - 2.7. Raportimi tek Bordi i Drejtorëve, Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut dhe/ose Menaxhmenti i Lartë, për të gjitha këto aktivitete duke përfshirë por pa u kufizuar në propozimin e veprimeve adekuata për zbutjen e rreziqeve.
3. Funkzioni i menaxhimit të rrezikut duhet të jetë mjaftueshëm i pavarur nga njësitë e biznesit dhe nuk duhet të jetë i përfshirë në gjenerimin e të hyrave. Ky funksion duhet të ketë qasje në të gjitha linjat e biznesit që kanë mundësi të gjenerojnë rreziqe materiale për bankën si dhe filialet e saj lidhur me këtë çështje.
  4. Funkzioni i menaxhimit të rrezikut duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët posedojnë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme, duke përfshirë njohuritë e tregut dhe produkteve të bankës, si dhe zotërimin e njohurive në fushat e rrezikut.

## **Neni 24**

### **Zyrtari Kryesor për Rrezik**

1. Bankat duhet të kenë një menaxher të lartë (Zyrtari Kryesor për Rrezik-(ZKR) ose ekuivalent me të) me përgjegjësi të përgjithshme për funksionin e menaxhimit të rrezikut të bankës.
2. ZKR-ja ka përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të funksionit të menaxhimit të rrezikut të bankës.
3. ZKR-ja është përgjegjës për mbështetjen e Bordit në angazhimin e tij për mbikëqyrjen e zhvillimit të deklaratës ose politikës për gatishmërinë e bankës ndaj rrezikut, si dhe përcaktimin e limiteve të rrezikut të caktuara në përputhje me deklaratën/politikën për gatishmërinë për rrezik. ZKR-ja së bashku me Menaxhmentin e Lartë duhet të jetë vazhdimisht i angazhuar në monitorimin e performancës të lidhur me marrjen e rrezikut si dhe respektimin e limiteve të rrezikut. Përgjegjësitë e ZKR-së gjithashtu përfshijnë edhe menaxhimin dhe pjesëmarrjen në proceset kryesore të vendimmarrjes (siç janë planifikimet strategjike, planifikimi i kapitalit dhe likuiditetit, shërbimet dhe produktet e reja, çështjet e kompensimit).

4. ZKR-ja duhet të ketë mandatin organizativ, autorizimet dhe kompetencën e nevojshme për të mbikëqyrur veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut të bankës. ZKR duhet të jetë i pavaruar dhe të ketë detyra të dallueshme nga funksionet tjera ekzekutive. Megjithatë ZKR-ja nuk duhet të ketë përgjegjësi menaxheriale apo financiare lidhur me asnjë linjë biznesi apo funksioni të gjenerimit të të ardhurave.
5. Derisa linjat zyrtare të raportimit mund të ndryshojnë ndërmjet bankave, ZKR-ja duhet të raportojë dhe të ketë qasje të drejtpërdrejtë në Bord ose në Komitetin e Menaxhimit të rrezikut pa ndonjë pengesë.

## **Neni 25**

### **Funksioni i pajtueshmërisë**

1. Bordi i Drejtorëve të një banke është përgjegjës për të siguruar se banka është në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse.
2. Për të kryer këtë përgjegjësi, Bordi duhet të sigurojë se funksioni i pajtueshmërisë vepron mbi baza proaktive dhe identifikon dokumentet dhe vlerëson rrezikun e pajtueshmërisë lidhur me veprimtaritë e biznesit të bankës, duke përfshirë zhvillimin e produkteve të reja, si dhe duhet të monitorojë rreziqet e mundshme nga mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi nga bankat.
3. Bordi i Drejtorëve është përgjegjës të sigurojë se është përgatitur një politikë e shkruar për themelimin e funksionit efikas të pajtueshmërisë dhe se është krijuar sistemi që do të sigurojë zbatimin efektiv të saj. Politika e funksionit të pajtueshmërisë duhet të jetë në përputhje me strategjinë e menaxhimit të rrezikut të bankës.
4. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që funksioni i pajtueshmërisë ka autorizimet dhe ndikimin e nevojshëm për të kryer funksionin e tij dhe se është i pajisur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për identifikimin efikas të rrezikut të pajtueshmërisë. Bordi i Drejtorëve është i detyruar të mbikëqyr administrimin e rrezikut të mos-pajtueshmërisë së bankës me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
5. Menaxhmenti i lartë do të miratojë procedurat e nevojshme për zbatimin adekuat dhe efikas të politikës së funksionit të pajtueshmërisë.
6. Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë janë përgjegjës për sigurimin e strukturës së nevojshme për krijimin e funksionit të pavarur të pajtueshmërisë, si në vijim:
  - 6.1. Themelimin e një statusi formal të funksionit të pajtueshmërisë brenda bankës;
  - 6.2. Emërimin e një personi apo caktimin e një njësie të veçantë ose ndonjë strukture tjetër organizative, për kryerjen e funksionit të pajtueshmërisë;

- 6.3. Të siguroj që funksioni i pajtueshmërisë është i vendosur në një pozicion që nuk do të shkaktoj konflikt të interesit duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësit e tjera;
- 6.4. Të sigurojë qasje në të gjitha informatat e nevojshme për personin, njësinë, departamentin, d.m.th punonjësit përgjegjës për kryerjen e funksionit të pajtueshmërisë, në mënyrë që tu mundësohet atyre që të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë efikase dhe efektive;
- 6.5. Krijimin e mekanizmit për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet personit, njësisë ose departamentit përgjegjës për kryerjen e funksionit të pajtueshmërisë dhe personave përgjegjës për menaxhimin e rrezikut, kontrollit financiar dhe çështjeve ligjore;
- 6.6. Personi i caktuar për funksionin e pajtueshmërisë, ose udhëheqësi i njësisë, ose ndonjë strukturë tjetër organizative e vendosur për funksionin e pajtueshmërisë duhet të informoj dhe të këshillojë menaxhmentin e lartë dhe t'i raportojë Bordit të Drejtorëve, i cili poashtu do të vendosë për kompensimin e tij/ saj;
- 6.7. Shkarkimin apo dorëheqjen e personit të caktuar për funksion të pajtueshmërisë ose të kryesuesit të njësisë apo strukturave të tjera organizative të pajtueshmërisë dhe shkaqet e kësaj do t'i komunikohen BQK-së brenda shtatë ditëve të punës pas shkarkimit apo dorëheqjes.
7. Personi, njësia, departamenti, pra, punonjësit në departamentin përgjegjës për kryerjen e funksionit të pajtueshmërisë duhet të jenë të mjaftueshëm në numër dhe të përshtatshëm për të siguruar që rreziku i pajtueshmërisë brenda bankës menaxhohet në mënyrë efektive. Po ashtu, bankat mund të krijojnë njësi të veçanta për fushat e specializuara siç janë: mbrojtja e të dhënave, mbrojtja e konsumatorit, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Megjithatë, funksioni i pajtueshmërisë do të kryejë kryesisht detyrat e mëposhtme në lidhje me identifikimin dhe monitorimin e rrezikut të pajtueshmërisë:
- 7.1. Përcjelljen dhe respektimin e rregulloreve që kanë të bëjnë me veprimtaritë bankare;
- 7.2. Identifikimin dhe monitorimin e rrezikut të mos-pajtueshmërisë së operacioneve bankare me rregulloret;
- 7.3. Monitorimin dhe testimin e pajtueshmërisë dhe raportimin tek menaxhmenti i lartë dhe Bordi i drejtorëve për mos-pajtueshmërinë e përcaktuar dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra për tejkalimin e tyre;
- 7.4. Këshillimin e vazhdueshëm dhe efikas të anëtarëve të menaxhmentit të lartë dhe Bordit të drejtorëve në zbatimin e rregulloreve;
- 7.5. Informimi dhe këshillimi i menaxhmentit të lartë dhe raportimi i drejtpërdrejtë tek Bordi i Drejtorëve ose një komiteti të Bordit të Drejtorëve të emëruar për pajtueshmëri në përputhje me politikën e funksionit të pajtueshmërisë;
- 7.6. Vlerësimin e ndikimit të mundshëm të rregulloreve dhe ndryshimeve të reja në operacionet bankare dhe mjedisin ku banka vepron;

- 7.7. Vlerësimin e harmonizimit të produkteve të reja dhe proceseve afariste në bankë në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- 7.8. Sigurimin e trajnimeve dhe informimit të punonjësve për mënyrat e zbatimit të ligjeve përkatëse dhe akteve nënligjore në operimin e tyre të përditshëm;
- 7.9. Bashkëpunimin me institucionet rregullative;
- 7.10. Dokumentimin e operacioneve të tij dhe paraqitjen e raporteve të rregullta informuese të menaxhmenti i lartë i bankës, në përputhje me politikën e funksionit të pajtueshmërisë.
8. Fushëveprimi dhe veprimtaritë e funksionit të pajtueshmërinë duhet t'i nënshtrohen rishikimit periodik nga funksioni i auditimit të brendshëm.

#### **Neni 26**

##### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

#### **Neni 27**

##### **Shtojca**

Forma e deklaratës për anëtarët e pavarur të Bordit të Drejtorëve është e përcaktuar në shtojcën e kësaj rregulloreje.

#### **Neni 28**

##### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për qeverisjen korporative të bankave e miratuar më 29 dhjetor 2016.

#### **Neni 29**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës



## DEKLARATË E ANËTARIT TË PAVARUR TË BORDIT

Unë deklaroj se i përmbush kërkesat e mëposhtme ligjore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për Anëtar të Pavarur të Bordit të Drejtorëve:

- Nuk kam asnjë marrëdhënie të drejtpërdrejtë apo të tërthortë interesi me bankën në aspektin e punësimit, përveç punësimit tim si anëtar i bordit ose në pozitën e këshilltarit të Bordit të ndonjë kompanie tjetër në kuadër të grupit;
- As unë, as bashkëshortja/ti im, ose të afërm të gjakut deri në shkallën e dytë, nuk kemi kapital ose marrëdhënie tregtare apo komerciale me bankën, filialet e saj, vartësit apo ndonjë kompani tjetër të grupit, aktualisht apo gjatë vitit të fundit.
- Nuk kam qenë i zgjedhur më parë në bordin e drejtorëve të bankës si përfaqësues i ndonjë grupi të caktuar të aksionarëve.
- Nuk kam qenë i punësuar në ndonjë kompani e cila ka ofruar shërbime të auditimit apo konsulence për Bankën gjatë gjashtë muajve të fundit.
- Nuk kam qenë i punësuar më parë nga ndonjë firmë që i ofron Bankës sasi të konsiderueshme të shërbimeve dhe produkteve dhe nuk kam pasur pozitë drejtuese në ndonjë kompani të tillë gjatë gjashtë muajve të fundit.
- As bashkëshortja/ti im apo ndonjë nga të afërmit e mi të gjakut deri në shkallën e dytë, nuk kanë ndonjë pozitë drejtuese në bankë dhe nuk janë aksionarë që posedojnë më shumë se 5% të kapitalit të përgjithshëm të ndonjë banke.
- Nuk jam i punësuar në pozitë ekzekutive të ndonjë kompanie tjetër ku ndonjëri nga ekzekutivët e asaj kompanie shërben në Bordin e bankës;
- Nuk kam marrë dhe nuk do të marr asnjë kompensim tjetër nga banka përveç kompensimit që më takon si Anëtar i Bordit / kompensimit si Këshilltar dhe përfitimeve të cekura në Aktet e Themelimit të Shoqërisë;
- Nuk kam aksione në ndonjë bankë, që tejkalojnë më shumë se 1% të kapitalit të bankës dhe nuk kam as nuk do të kem aksione të preferuara;
- Gjykimi im do të ushtrohet vetëm për të mirën e bankës dhe unë nuk kam asnjë konflikt të perceptuar apo aktual të interesit që rrjedh nga marrëdhëniet e mia me bankën dhe me palët e ndërlidhura me bankën që do të mund të më pengojnë të veproj si një drejtor i pavarur.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Institucioni: \_\_\_\_\_

---

*Deklarata i bashkëngjitet formave të aplikimit që kërkohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës*